Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosova
ZYRA RREGULLATORE PËR UJËSJELLËS DHE KANALIZIM
REGULATORNI URED ZA VODU I KANALIZACIJU
WATER AND WASTEWATER REGULATORY OFFICE
ZRRUK

Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim

Furnizimi me ujë dhe shërbimet e ujërave të zeza

PROCEDURAT PER RISHIKIMIN TARIFOR 2015 – 2017

Qershor 2011

PROGRAMI I KONTROLLIMIT TË NDRYSHIMEVE				
Verzioni i shqyrtuar	**Data e shqyrtimit**	**Autori**	**Aprovuar**	**Detajet e ndryshimeve**

Përmbajtje

Hyrje 1

Përkufizimet 2

1. Variacionet parimore të rishikimit tarifor 2009-2011 dhe mësimet e mësuara 4

1.1 Biznes plani rregullator 4
1.2 Kompleksiteti dhe përdorimi i modelit 4
1.3 Përshtatjet nga performanca në të kaluarën 5
1.4 Tatimi dhe kthimi në kapital 5
1.5 TVSH e parimbursuar 6
1.6 Inflacioni dhe indeksimi 6

2. Konceptet e përgjithshme 7

2.1 Kompanitë Rajonale të Ujit 7
2.2 Obligimet, politikat dhe udhëzimet 7
2.3 Orari 7
2.4 Rishikimi i procesit 8

3. Parimet e llogaritjes së tarifave të ujit 9

3.2 Çmimet reale 9
3.3 Zbutja tarifore 9

4. Paraqitja e modelit tarifor 10

4.1 Platforma e modelit 10
4.2 Burimi i të dhënave hyrëse 10
4.3 Koncepti i modelit 10

5. Llogaritja e shitjes 12

5.1 Logjika 12

6. Pasqyrimi i kërkesave për të ardhura 13

7. Shpenzimet operative 14

7.1 Të përgjithshme 14

8. Zhvlerësimi i kostos aktuale 15

8.1 Të përgjithshme 15
8.2 ZHKA në vlerën fillestare (2009) të bazës rregullatore të asetit 15
8.3 ZHKA në asetet ekzistuese jo-infrastrukturore 15
8.4 ZHKA në asetet e reja jo-infrastrukturore 15

9. Përtritjet infrastrukturore dhe rritjet infrastrukturore 16

9.1 Koncepti 16

10. Kontributet kapitale 17

10.1 Kontributet kapitale 17
10.2 Taksa e Kyçjes 17

11. Baza rregullatore e aseteve 18

11.1 Koncepti 18
11.2 Vlera fillestare e aseteve rregullatore 18
11.3 Kapitali punues i përfshirë në bazën rregullatore të aseteve 18

12. Kthimi në kapital 19

12.1 Niveli 19
12.2 Përfshirja në kërkesën për të ardhura 19
13. Llogaritja e tarifave 20
13.1 Koncepti 20
13.2 Zbutja 20
14. Indeksimi 21
14.1 Koncepti 21
14.2 Metoda 21

HYRJE

Ky dokument përcakton procedurat të cilat duhet të respektohen nga Kompanitë Rajonale të Ujit (KRU) për aplikimin tarifor të kërkuar për shërbimet e Furnizimit me ujë dhe Ujërave të zeza të përfshira për periudhën 2015 deri në 2017. Baza për dorëzimin e aplikacionit tarifor për periudhën 2015 deri në 2017 është korniza e planit të biznesit të KRU përmes së cilës tarifat do të jenë të mjaftueshme për të financuar aktivitetet dhe nivelet e performancës siç është paraparë në Biznes Planin Rregullator. Pas procesit shqyrtues të rregullatorit nivelet përfundimisht të pajtuara të performancës do të bëhen zotime në shkëmbim të aprovimit të tarifave nga ZRRUK që janë përcaktuar si të mjaftueshme për arritjen e këtyre caqeve. Performanca në vijim e KRU do të matet kundrejt këtyre caqeve të performancës.

E rëndësishme në këto procedura është caktimi i një kalendari rregullator, përshkrimi i një afati kohor të arsyeshëm për kërkesat e informimit, aplikimit tarifor, konsultave dhe proceset e aprovimit. Është me rëndësi që ZRRUK dhe KRU të punojnë në pajtim me programin e planifikuar në mënyrë që të arrihen afatet kohore specifike për tarifat e reja të cilat do të zbatohen. Informacioni i kërkuar për raportimin periodik duhet të përfshijë përkufizime të ngjashme në mënyrë që të monitorohet në mënyrë efektive performanca aktuale kundrejt projektimeve të bëra në lidhje me rishikimet e tarifave dhe të reduktohet mundësia e dyfishimit të panevojshëm dhe keqinterpretimit.

Zbatimi i këtyre procedurave varet plotësisht nga KRU të cilët do të ofrojnë informacionet e nevojshme në formatin e kërkuar të biznes planit nga ZRRUK. Në këtë rishikim ky informacion është i obligueshëm pasi që procesi i llogaritjes së tarifave është një komponentë integrale e modelit të biznes planit rregullator. Mosdhënia e informacioneve në formatin e kërkuar do të konsiderojë dorëzimet e tarifave jo valide (pa forcë ligjore).

PËRKUFIZIMET

Asetet infrastrukturore: Kryesisht asete nëntokësore me jetëgjatësi të pakufizuar dhe të cilat nëse mirëmbahen në mënyrë të duhur, do të mund të vazhdojnë me ofrimin e nivelit të përcaktuar të shërbimeve, konsumatorëve, për një kohë të gjatë.

Asetet jo-infrastrukturore: Asete (kryesisht mbitokësore) të cilat kanë një jetëgjatësi të kufizuar prandaj edhe zhvlerësohen gjatë kësaj kohe dhe mund të zëvendësohen në fund të jetës së tyre.

Baza rregullatore e aseteve "BRA": Baza kapitale e përdorur në vendosjen e limit të tarifave. Kjo është vlera e aseteve të Kompanive Rajonale të Ujit e cila përfiton kthimin kthimin në investime. Kjo paraqet vlerën fillestare të investimeve dhe neto shpenzimet e reja kapitale. Vlera kapitale llogaritet pas zhvlerësimit të kostos aktuale.

Bilanci furnizim–kërkesë: Diferenca në mes të furnizimit dhe kërkesës, ose përmes kërkesës nga konsumatorët e ri apo kërkesës së rritur nga konsumatorët ekzistues për të cilët nevojiten investime shtesë për tu siguruar që kërkesa për shërbime është plotësuar.

Borxhet e pakthyeshme: Lejimi i provizionimit të mospagesës nga ana e Kompanive Rajonale të Ujit për të cilat nuk ka perspektivë të arsyeshme se do të arkëtohen prandaj edhe duhet të kualifikohen si shlyerje të borxhit në pajtim me praktikat konvencionale të kontabilitetit.

Çmimet reale: Shpenzimet dhe të ardhurat e shprehura në çmime, për një datë të caktuar, p.sh. mesi i vitit 2011.

Grantet: Financimi i siguruar për investime apo ofrimin e shërbimeve për të cilat nuk kërkohet ri-pagim. Investimet e infrastrukturës të financuara nga grantet nuk i shtohen as shpenzimeve për përtritjen e infrastrukturës dhe as bazës rregullatore të asetit.

Indeksimi: Shpenzimet dhe të ardhurat e përshtatura për inflacion në pajtim me treguesit e inflacionit.

Kalendari rregullatorë: Një orar i aktiviteteve të cilat do të ndërmerren nga KRU, ZRRUM dhe të tjerët në mënyrë që të kryhen detyrimet brenda afateve kohore të caktuara. Aktivitetet përfshijnë përgatitjen e procedurave, konsultimeve, testimeve, kërkesës për informacione, propozimet për tarifa, aprovimet dhe adoptimet.

Kapitali punues: Kapitali i nevojshëm për të financuar kërkesat e rrjedhjes së parasë, të KRU. Në kontekst të këtyre procedurave, kapitali punues duhet të përfshihet në bazën rregullatore të aseteve dhe nuk do të bëhen përshtatje për ndryshimet në kapitalin punues.

Kërkesat për të ardhura: Kërkesa për të ardhura vjetore të nevojshme për të financuar aktivitetet e KRU duke përfshirë kthimin në kapital. Kjo përfshinë: shpenzimet operative; koston e rritjes infrastrukturore; zhvlerësimin e shpenzimeve qarkulluese; kthimin në BRA dhe shpenzimet tjera sipas nevojës.

Kontimi i zhvlerësimit sipas kostos aktuale: Metoda e kontabilitetit, fillimisht e përcaktuar për çështjen e paraqitjes së inflacionit në fitimet e bizneseve. Në vend që asetet të paraqiten me çmimet e tyre historike, (d.m.th me çmimin e tyre origjinal të blerjes), pa zhvlerësim nëse është nevoja, asetet janë më mirë të paraqitura me çmimet aktuale të tyre (koston zëvendësuese), në kohën e krijimit të llogarive. Kjo metodë e kontabilitetit përdoret në industrinë ujit për shkak të karakterit të gjerë të aseteve kapitale dhe faktit që çmimet historike nuk reflektojnë vlerën e vërtetë të aseteve.

Kontributet kapitale: Financimi i siguruar si kontribut ndaj investimeve nga pala e tretë, p.sh taksat e infrastrukturës dhe kontributet për aktivitetet siç janë devijimet e gypave.

Kthimi në kapital: Kthimi në bazën rregullatore të aseteve i paraqitur si të ardhura vjetore dhe rritja e kapitalit nga investimet të shprehura si përqindje e investimit origjinal.

Mirëmbajtja kapitale: Aktiviteti i planifikuar, i kryer nga Kompanitë Rajonale të Ujit për të zëvendësuar dhe riparuar asetet e furnizimit me ujë dhe ujëra të zeza me qëllim të ofrimit të shërbimeve bazë për konsumatorë.

Mos indeksimi: Shpenzimet dhe të ardhurat të cilat nuk janë rregulluar për normën e inflacionit**.**

Nivelet e ngritura të shërbimit: Përmirësimet e përhershme, të identifikueshme dhe të matshme të niveleve të shërbimeve që janë mbi nivelin aktual bazë.

Rritja: Rritja e bazës së aseteve përmes niveleve të ngritura të shërbimit dhe/ose zgjerimit të sistemit.

Shpenzimet e përtritjes së infrastrukturës: Provizionim vjetor në kontabilitet për shpenzimet e rritjes së vlerës së aseteve të infrastrukturës (d.m.th kryesisht nëntokësore) e paraqitur në pasqyrën rregullatore të fitimit/humbjeve.

Shpenzimet operative: Shpenzimet direkte operative lidhur me ofrimin e shërbimeve që përfshijnë: fuqinë punëtore; energjinë; kemikaljet; materiet konsumuese; shpenzimet e përbashkëta; taksat e pa-rimbursueshme dhe shpenzimet tjera.

Zbutja tarifore: Procesi i përshtatjes së outputeve tarifore për të zëvendësuar lëkundjet e mëdha të çmimeve me një përshtatje të përqindjes ekuivalente uniforme (apo pothuajse uniforme), por përsëri duke e mirëmbajtur të njëjtën vlerë të tanishme neto (NTN) të rrjedhës së të ardhurave.

Zhvlerësimi i kostos aktuale: Zhvlerësimi i llogaritur në pajtim me metodat e zhvlerësimit sipas kostos aktuale.

1. VARIACIONET PARIMORE TË RISHIKIMIT TARIFOR 2009-2011 DHE MËSIMET E MËSUARA

1.1 Biznes plani rregullator

1.1.1 Procesi i rishikimit të tarifave për vitet 2009 – 2011 është ndërmarr në mungesë të një biznes plani të detajuar, i cili do të duhej te aplikohej gjatë rishikimit tarifor. Si pasojë e kësaj, biznes plani ka qenë i përbërë prej një sërë planesh të projektimeve të shpenzimeve dhe planeve të investimeve, të cilët kanë qenë në kufij të ulët të saktësisë dhe janë bazuar shumë pak ose fare në strategjinë e planifikimit të përgjithshëm të biznesit. Si rezultat, shumë inpute të tarifave nuk janë konsideruar si të qëndrueshme. Kjo ka qenë në veçanti e rëndësishme për faktin se programi aktual i investimeve ishte planifikuar në baza jo të qëndrueshme. Kjo ka ndodh kryesisht për arsye të pamundësisë që KRU të arrijnë nivelin e pritur të arkëtimeve, të cilat kanë qenë në fakt të ardhurat kryesore për modelin tarifor.

1.1.2 Në këtë rishikim tarifor të viteve 2015 – 2017 ZRRUK ka specifikuar një kornizë të hollësishme të planit të biznesit e cila kërkon nga KRU të dorëzojnë plane të hollësishme dhe të menduara mirë, të dizajnuara për t'i plotësuar nivelet specifike të shërbimeve dhe pritjet në performancë. Këto plane të biznesit e formojnë bazën e inputeve të modelit për llogaritjen e tarifave.

1.2 Kompleksiteti dhe përdorimi i modelit

1.2.1 Modeli i tarifave i zhvilluar nga ZRRUK për rishikimin e tarifave për vitet 2015 – 2017 është konsideruar nga personeli teknik dhe financiar i KRU të jetë tejet kompleks dhe që ka kërkuar trajnim të gjerë për përdorimin e tij. Ky aspekt është pranuar në rishikimin e tarifave për 2015 – 2017 në dy mënyra:

1. Ndonëse modeli tarifor për 2015 – 2017 është shumë i ngjashëm me modelin e tarifave për 2009 – 2011, janë bërë disa thjeshtësime, dhe;
2. Modeli është zhvilluar si një nën komponent e planit të biznesit dhe nuk ka nevojë për inputin direkt operativ.

1.2.2 Si pasojë e kësaj, këto përmirësime, posaçërisht nën 2 më lartë, rezultojnë në disa përparësi të mëdha, si:

1. Nuk ka nevojë për ekipin e KRU që merret me tarifa që të kuptojnë për së afërmi funksionimin e modelit të tarifave pasi që inputet e modelit (kostot, performanca, kriteret ekonomike, etj.) derivojnë nga plani i biznesit dhe automatikisht dërgohen në modelin e tarifave dhe përmes outputeve të modelit (tarifat) kthehen automatikisht te plani i biznesit. Ekipi i KRU per tarifa duhet vetëm të dijë kërkesat e hollësishme të planit të biznesit[1];
2. Menaxhmenti i KRU, në përgatitjen e planit të tyre të biznesit, do të shohin menjëherë implikimet e tarifave nga inputet e planit të biznesit dhe mund të përshtatin planet e tyre në pajtueshmëri me të;
3. ZRRUK mund të shqyrtojë planet më hollësisht se sa në rishikimet e mëhershme përmes krahasimeve të drejtpërdrejta në mes të tarifave dhe aktiviteteve për planifikimin e biznesit dhe nivelet e shërbimeve të synuara.

1.2.3 Kjo kornizë e re, megjithatë kërkon që KRU të dorëzojnë planet e tyre të biznesit në formatin e kërkuar të ZRRUK nëse dëshirojnë që propozimet e tyre për tarifa të jenë të suksesshme.

[1] Ndonëse stafit të KRU nuk i nevojitet një kuptim i hollësishëm i modelit të tarifave, megjithatë do të ishte e përshtatshme për ta se për cilin model do të ofroheshin informacionet udhëzuese në kohën e duhur.

1.3 Përshtatjet nga performanca në të kaluarën

1.3.1 Rishikimi i tarifave për 2009 – 2011 ka filluar me nivelin bazë të shërbimeve dhe tarifat e vëna nuk kanë pasur asnjë dispozitë të 'ngritjes/uljes'[2] duke u bazuar në performancën e së kaluarës. Performanca në vijim e KRU që nga viti 2009 ka qenë e tillë sa që ato nuk i kanë arritur pritjet e arkëtimeve të cilat kanë rezultuar me mungesë të parasë të cilat si pasojë kanë vështirësuar aftësitë e tyre për të kryer detyrimet e tyre, posaçërisht investimet. Nëse performanca e arkëtimit ka qenë ashtu siç është pritë në rishikimin tarifor, do të arsyetohej ushtrimi i ngritjes/uljes në atë se bilanci i suficitit të parasë (nga arkëtimet e pranuara që nuk janë shpenzuar në investime) do të mund të përcillej në periudhën e ardhshme të rishikimit tarifor. Megjithatë, në realitet, do të mund të konsiderohej si padrejtësi që të bazoheshim në paratë e KRU të cilat ata nuk i kanë arkëtuar fillimisht, pavarësisht prej asaj se ku është faji për mos arritjen e synimeve të arkëtimit dhe nëse do të veprohej në këtë mënyrë do t'i privonte ata nga paratë të cilat do t'i nevojiteshin për investime në të ardhmen. Në raste ekstreme, një politikë e tillë do të mund të rrezikonte realizueshmërinë financiare të tyre.

1.3.2 ZRRUK ballafaqohet me një rrezik moral; nëse cakton procesin e ngritjes/uljes, kjo do të ndikonte shumë në realizueshmërinë financiare të KRU por nëse nuk do të veprohej në këtë mënyrë do t'i dërgonte një sinjal KRU se ato nuk kanë asnjë detyrim për t'i arritë objektivat dhe zotimet e paraqitura në planet e tyre të biznesit.

1.3.3 Rishikimi tarifor për periudhën 2015 – 2017 nuk do të përfshijë procesin e ngritjes/uljes së performancës dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën e kaluar tarifore. Përveç kësaj, ka më pak gjasa që rishikimi i ardhshëm tarifor të përfshijë një proces me të dhëna të tilla. Por, nëse do të ketë në ndërkohë ndryshime të rëndësishme institucionale dhe ku struktura pronësore e KRU do të ndryshonte rrënjësisht nga statusi i tyre aktual si ndërmarrje publike, atëherë mund të merret në konsideratë.

1.4 Tatimi dhe kthimi në kapital

1.4.1 Ndonëse rishikimi tarifor për 2009 – 2011 specifikon se shpenzimet operative duhet të përshijnë tatimet e parimbursueshme, ky provizionim ka pasur kryesisht të bëjë me tatimin e korporatës, dhe ka marrur parasysh se KRU kanë ndërtuar me kohë sistem të tillë të mbulimit të tatimeve që çfarëdo profiti i taksueshëm do të mund të gjenerohej. Si rrjedhoj, ndonëse kthimi në kapital është përkufizuar si kthim post tatimor ka qenë në fakt gjithashtu edhe kthim para tatimor pasi që nuk ka pasur gjasa që të paguhen tatimet. Megjithatë pritet që në një kohë të caktuar gjatë periudhës 2015 – 2017 KRU të mund të realizojnë profite të taksueshme, edhe pse mburoja tatimore mund të jetë ende e mjaftueshme për të zvogëluar detyrimet tatimore në zero gjatë kësaj periudhe. Përcaktimi i kthimit post-tatimor në kapital kërkon vlerësim paraprak të detyrimeve të tatimit të korporatës në kërkesat për të ardhura; një proces mjaft i komplikuar. Ky proces i rishikimit të tarifave për periudhën 2015 – 2017 do të përfshijë kthimin në kapital para tatimor i cili mjafton për të kënaqur të dyja: autoritetin tatimor dhe pritjet e investitorit. Pritet që kthimi në kapital do të rishqyrtohet nga niveli i përcaktuar në periudhat e rishkimeve tarifore 2009-2011 dhe 2012-2014 që të lejojë tatimin e korporatës (aktualisht 10%), në këtë mënyrë duke e nënkuptuar minimumin prej një shtese prej 0.4% që do t'i shtohej kthimit në kapital.

1.4.2 Pavarësisht prej nevojës për të rritur kthimin në kapital në një nivel të duhur para tatimor, konsiderohet se përqindja e ofruar më herët ka qenë më e ulët se sa përqindja aktuale e huazimit dhe prandaj edhe i pamjaftueshëm për KRU që të krijojnë nivele të kthimit që do të ishin tërheqëse për investime. Këto procedura propozojnë një nivel më të lartë të kthimit në kapital se sa që është ofruar më herët (i nënshtrohet analizës së propozimeve të tarifave dhe aprovimit nga ZRRUK).

[2] 'Ngitja/ulja' është një proces i kthimit të parasë nga rishikimet tarifore në të kaluarën të cilat janë lejuar në rishikimin tarifor për aktivitete të caktuara por të cilat nuk janë realizuar, p.sh. mos plotësimi i zotimeve nga plani i investimeve.

1.5 TVSH e parimbursuar

1.5.1 Rishikimi i fundit i tarifave ka supozuar se TVSH në faturim të pa arkëtuar do të rimbursohet (efektivisht TVSH do t'i paguhej autoriteteve tatimore vetëm për faturat e arkëtuara). Si pasojë, modeli i tarifave ka qenë neutral ndaj TVSH. Është kuptuar se TVSH e rimbursuar është e pranueshme nëse shumat e papaguara fshihen dhe të arrihet pajtimi me autoritetin tatimor që të bëjë të njëjtën gjë poashtu. Një leje e tillë, megjithatë, nuk është dhënë dhe prandaj nga KRU kërkohet që të paguhet TVSH për faturat e pa arkëtuara. Në realitet, autoritetet tatimore kanë siguruar një koncesion për KRU që të paguajnë TVSH vetëm për faturat e arkëtuara por TVSH në faturat e pa arkëtuara do të shtyhet për pagesë (por jo të shlyhet). Si pasojë, KRU kanë të akumuluar (sipas akrualit) një shumë të madhe të TVSH së papaguar, e cila në një fazë të caktuar në të ardhmen do të duhet të paguhet plotësisht (ndoshta edhe me interes). Kjo i ngritë dy çështje që duhet të konsiderohen për rishikimin e tarifave për periudhën 2015 – 2017 e që ndërlidhet me vendimmarrjen e autoriteteve përkatëse, dhe atë

1. Nëse TVSH në faturat e pa arkëtuara do të paguhej në baza vjetore dhe do të kërkohej një përshtatje e kërkesave të të ardhurave, dhe:
2. Nëse shuma akruale në të kaluarën (borxhet e TVSH) do të duhej të paguhej poashtu, atëherë do të ishte e nevojshme të bëhej një përshtatje shtesë në kërkesën për të ardhura (varur nga periudha e marrëveshjes për ripagim dhe kamatës (nëse ka)).

1.5.2 Modeli i tarifave është zhvilluar që t'i shërbejë çështjes së parë prej këtyre dy çështjeve si një kontroll opsional, p.sh. tarifat dhe outputet e planit të biznesit në vijim mund të përcaktohen me ose pa kushtëzimin e TVSH në faturat e pa arkëtuara, që duhet t'i paguhen autoritetit tatimor.

1.5.3 Shuma akruale e TVSH e akumuluar nga e kaluara nuk pritet që të hyjë në periudhën e rishikimit të tanishëm tarifor dhe prandaj nuk është ofruar as në modelin tarifor e as në planin e biznesit. Nëse brenda periudhës së rishikimit ka qenë një kërkesë për pagimin e shumës së akrualit tek autoriteti tatimor atëherë do të kërkohej një provizionim i veçantë në kërkesat e të ardhurave, dhe nëse ka nevojë do të ishte si bazë për KRU që të kërkojnë një përshtatje të përkohshme për tarifa, përpos atyre për të cilat janë pajtuar në rishikim.

1.6 Inflacioni dhe indeksimi

1.6.1 Rezultati i rishikimit të tarifave të 2009 – 2011 ka qenë një plan i tarifave për secilën KRU për një periudhë tre vjeçare të caktuar në nivelin e çmimeve në mesin e vitit 2008. Qëllimi ka qenë që tarifat do të përshtateshin çdo vit për inflacionin vjetor duke u bazuar në treguesit e inflacionit nga viti i kaluar. Megjithatë në praktikë, ZRRUK nuk i ka aplikuar treguesit e inflacionit duke rezultuar në atë se tarifat me kalimin e kohës kanë qenë më të ulëta se sa që është dashur të jenë. Ky rishikim tarifor 2015 – 2017 do të përcaktojë përsëri tarifat në bazë të çmimeve të vitit bazë (mesi i vitit 2014) dhe do të kërkojë përshtatje çdo vit për inflacion. ZRRUK dhe KRU duhet të sigurohen se do të bëhen përshtatjet e tilla.

2. KONCEPTET E PËRGJITHSHME

2.1 Kompanitë Rajonale të Ujit

2.1.1 Metodologjia e caktimit të çmimeve e adoptuar për KRU bazohet në statusin e tyre si ndërmarrje publike dhe i nënshtrohen kodit të kompanive në Kosovë. Ato aktualisht nuk krijojnë divident për aksionarët e tyre dhe të gjitha përfitimet neto ri-investohen në biznes. Ndonëse metodologjia e paraqitur në këto procedura bazohet në parimet ekonomike konvencionale të rregullatorit, përshtatjet e tilla për nën-performancë dhe mbi-performancë në një mënyrë më komplekse do të përfshiheshin në strukturat e kompanive private (divestitura apo koncesionet afatgjate), ndërsa këtu janë të një rëndësie të kufizuar, prandaj edhe përjashtohen nga këto procedura. Rishikimet tarifore në të ardhmen, megjithatë mund të marrin parasysh këtë aspekt varësisht prej kornizës institucionale në të ardhmen dhe rolit të sektorit privat. Kjo megjithatë nuk do të thotë se ZRRUK nuk duhet të interesohet për performancën dhe realizimin por më shumë duhet të jetë i kënaqur që performanca është në pajtim me pritjet dhe se KRU janë në rrugë të arritjes së caqeve të qëndrueshmërisë financiare dhe kryerjes së detyrimeve të tyre të shërbimeve në pajtim me standardet e BE dhe Kosovës.

2.2 Obligimet, politikat dhe udhëzimet

Këto procedura i paraqesin propozimet në hollësi për caktimin e tarifave të ujit. Ato bazohen në detyrimet statusore të parapara me *Dispozitat e caktimit të tarifave të Ligjit nr. 03/L-086 dhe Rregulloren e ZRRUM (Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2004/49)*[3]. Për qëllime të këtyre referimeve të politikave në Ligjin nr. 03/L-086 dhe Rregullores së ZRRUM (Rregullorja e UNMIK Nr. 2004/49) referohen si 'Ligj'. Ato gjithashtu mbështetën në parimet e Politikave Tarifore të ZRRUK për Furnizim me Ujë dhe Shërbimet e Ujërave të Zeza *(2014).*

2.3 Orari

2.3.1 Aktivitetet parimore në lidhje me rishikimin e tarifave për vitet 2012 – 2014, ashtu siç janë paraqitë nga ZRRUM në kalendarin rregullator të miratuar, janë paraqitë në Tabela 2-1 më poshtë.

Tabela 2-1. Kalendari Rregullator për rishikimin e tarifave për vitet 2015 – 2017 (ekstrakt nga kalendari rregullator i miratuar nga ZRRUK)

Afati	Aktiviteti i KRU	Përgjegjësia	
		KRU	ZRRUM
Qershor 2014	Lëshimi i Procedurave dhe Modelit përfundimtarë të Përcaktimit të Tarifave	●	●
30 Qer 2014	Dorëzimi i aplikacioneve për tarifa, planeve të përditësuara të biznesit dhe informacioneve mbështetëse, të bazuara në Procedurat Përfundimtare Dorëzimi i Llogarive Rregullatore për vitet 2009 dhe 2010	●	
31 Tet 2014	Lëshimi i draft aplikacioneve tarifore		●
15 Nën 2014	Afati për komente nga KRU mbi draft tarifat e përcaktuara	●	
30 Nën 2014	Lëshimi i raporteve përfundimtare të tarifave dhe urdhëresave tarifore për 2015 deri 2017		●
15 Dhje 2014	Afati për ankesa kundrejt urdhëresave tarifore	●	
1 Jan 2015	Adoptimi (hyrja në fuqi) i tarifave për vitin 2012, të rregulluara (përshtatura) në pajtim me kriteret për inflacion	●	

[3] Për qëllime të kësaj politike, referimi në *Ligj Nr. 03/L-086* dhe *Rregulloren e ZRRUM (Rregullorja e UNMIK Nr. 2004/49)* referohen si 'Ligj'

2.4 Rishikimi i procesit

2.4.1 Procesi për dorëzimin e aplikacionit për tarifa varet nga biznes planet rregullatore, kontabiliteti rregullatori dhe nga dokumente tjerë mbështetëse të ZRRUK, këto të fundit duhet të inkorporohen në modelin e biznes planit rregullator. Ky proces është ilustruar në Figura 2-1 më poshtë.



Figura 2-1 Përshkrimi i procesit të caktimit të tarifave

2.4.2 Rezultatet kryesore të procesit janë:

1. Dorëzimi i aplikacionit të detajizuara tarifor në ZRRUK;
2. Caqet dhe zotimet mbi performancën dhe investimet të cilat do të përdoren më pas si bazë për monitorimin e performancës;
3. Pasqyrat e projektuara financiare dhe rregullatore (bilanci i gjendjes, pasqyra e të ardhurave dhe ajo e rrjedhjes së parasë).

2.4.3 Me rastin e pranimit të aplikacioneve tarifore, së bashku me Biznes planin rregullator, ZRRUK do të rishqyrtoj, dhe kur është e nevojshme do të kërkojë që të bëhen ndryshime në plan të biznesit, kur vlerëson se pritjet e performancës, kostot dhe kriteret tjera janë jo reale dhe nuk janë mjaft sfiduese.

2.4.4 Tarifat finale të miratuara nga ZRRUK, së bashku me pritjet e pajtuara të performancës, kostot dhe kriteret tjera, do të formojnë një marrëveshje në mes të ZRRUK dhe KRU, d.m.th. tarifat e miratuara në shkëmbim të zotimit për realizimin e performancës dhe kryerjen e detyrimeve të investimeve.

3. PARIMET E LLOGARITJES SË TARIFAVE TË UJIT

3.1.1 Llogaritja e tarifave të ujit bazohet në çmimet e caktuara për të plotësuar nevojat e KRU në kërkesën për të ardhura. Kjo kërkesë e të ardhurave, përfshinë:

1. Shpenzimet operative: puna, energjia, materialet e konsumueshme, kemikalet, pagat, tatimet e pakthyeshme [4], dhe shpenzimet e përsëritura
2. Mirëmbajtja e kapitalit: shpenzimet e rritjes të infrastrukturës, zhvlerësimi dhe mekanizmat e tjerë të nevojshëm
3. Kthimi në kapital: një kthim i drejtë në bazës rregullatore të asetit të financuar nga KRU.

3.1.2 Një parim fundamental i këtyre procedurave është se KRU do të kenë të drejtë për një qarkullim të të ardhurave të mjaftueshme për të financuar aktivitetet e tyre por njëkohësisht do të sigurohen që kthimi në kapital të jetë i kufizuar në përfaqësim të drejtë të investimeve të bëra nga KRU, p.sh. investimet e financuara përmes granteve nuk kualifikohen si kapital në bazë të cilit mund të bëhet kthimi.

3.1.3 Këto procedura bazohen në rishikim periodik (3 vjeçar).

3.1.4 Një element i rëndësishëm i kërkesave të të ardhurave në bazë të cilave llogariten tarifat është financimi i nevojshëm për mirëmbajtjen kapitale, rritjen dhe përtëritjes së sistemit. Këto procedura bazohen në supozimin se lejimet e siguruara për kërkesat e të ardhurave reflektojnë shpenzimet aktuale.

3.2 Çmimet reale

3.2.1 Të gjitha shpenzimet dhe outputet e tarifave caktohen në nivele të vitit bazik, ku data bazë është mesi i vitit i cili i paraprinë fillimit të periudhës së rishikimit të çmimeve, p.sh. të gjitha shpenzimet dhe tarifat caktohen në bazë të çmimeve të mesit të vitit 2014.

3.2.2 Tarifa për vitin e parë të periudhës së rishikimit të tarifave do të caktohet mbi bazën e çmimit të mesit të vitit paraprak të shumëzuar me indeksin e inflacionit (deri në Nëntor 2014[5]) për vitin paraprak.

3.2.3 Tarifat në vazhdim do të përshtaten me shifrat e inflacionit të vitit paraprijës.

3.2.4 Tarifat i nënshtrohen rritjeve reale (apo uljeve) siç përcaktohet me këto procedura

3.3 Zbutja tarifore

3.3.1 Procedurat janë dizajnuar që të zbusin çmimet gjatë periudhës së rishikimit tri vjeçar për të kufizuar ndikimin e kundërt të goditjeve të çmimeve dhe lëkundjeve.

[4] Nuk është përshtatë në rishikimin e tarifave të viteve 2009 – 2011 TVSH e pakthyeshme në faturat e pa arkëtuara. Kjo çështje është paraqitë në planin e biznesit dhe në modelin tarifor si një kontroll opcional.

[5] Nëntori 2014 është zgjedhur si muaji i inflacionit pasi që ky është treguesi më i hershëm i inflacionit i cli do të vihet në dispozicion para se të publikohet urdhëresa tarifore në Dhjetor të çdo viti për të hyrë në fuqi nga Janari.

4. PARAQITJA E MODELIT TARIFOR

4.1 Platforma e modelit

4.1.1 Modeli i tarifave është zhvilluar për këtë rishikim tarifor 2015 – 2017 si një nën komponent e bashkangjitur në modelin e Biznes planit rregullator, të dy të hartuar në MS Excel.

4.1.2 Modeli i tarifave është dizajnuar në atë mënyrë që nuk ka kërkesë për operatorin që të vë në funksion modelin në mënyrë manuale; inputet nga modeli i planit të biznesit dhe outputet e modelit të planit të biznesit krijohen në mënyrë automatike.

4.1.3 Nën-komponenti i modelit tarifor është i mbrojtur për tu siguruar nga korruptimi i paqëllimshëm i dokumentit.

4.2 Burimi i të dhënave hyrëse

4.2.1 Të dhënat hyrëse të kërkuara në modelin e tarifave plotësisht derivojnë nga plani i biznesit. Plani i biznesit do të merr informacionet e veta nga burimet e ndryshme duke përfshirë:

1. Performancën dhe projektimet e investimeve nga KRU: p.sh. prodhimi i ujit dhe projektimet e shitjeve (duke përfshirë vlerësimin e UPF), projektimet e arkëtimit, projektimet e shpenzimeve operative, planet e investimeve (duke përfshirë pagesën e mbetur nga mirëmbajtja e kapitalit), pritjet e zgjerimeve të shërbimeve, kërkesat e mbulimit të borxheve (kamata dhe kthimi i kredisë), etj;
2. Llogaritë rregullatore: p.sh. baza rregullatore e aseteve, zhvlerësimi sipas kostos aktuale, përtritjet infrastrukturore, etj;
3. Pasqyrat financiare të audituara (dhe të pa audituara) nga KRU: p.sh. pasqyra e të ardhurave, regjistrat e aseteve, planet e kredive, regjistrat e qendrave të kostos, raportet e performancës, etj.;
4. Udhëzimi nga ZRRUK: Kthimi në kapital, kushtet e kufizimit, etj.;
5. Burimet tjera, p.sh. statistikat e inflacionit, etj.

4.3 Koncepti i modelit

4.3.1 Modeli bazohet në caktimin e tarifave për çdo vit të cilat do të sigurojnë një rrjedhje të të ardhurave i cili i përgjigjet kërkesave për të ardhura (i krijuar prej shpenzimeve operative, mirëmbajtjes kapitale dhe kthimit para tatimor në kapital). Tarifa mesatare e caktuar në baza vjetore është kërkesa për të ardhura e pjesëtuar me nivelin e pritur të shitjeve për atë vit.

4.3.2 Kostoja e aktiviteteve operative e financuar përmes granteve nuk përfshihet në kërkesën për të ardhura.

4.3.3 Mirëmbajtja kapitale (përtritjet infrastrukturore dhe zhvlerësimi i kostos aktuale) financuar përmes granteve gjithashtu nuk përfshihet në kërkesat për të ardhura.

4.3.4 Trajtimi i mirëmbajtës kapitale varet nga fakti se a janë shpenzimet e tilla për mirëmbajtjen e aseteve infrastrukturore (zakonisht nëntokësore) apo të aseteve jo-infrastrukturore (referohuni pikës 8 dhe 9).

4.3.5 Investimet kapitale në rritjen e aseteve infrastrukturore i shtohet bazës rregullatore të aseteve, mirëpo jo edhe ato të financuara nga grantet.

4.3.6 Investimet kapitale në asetet jo-infrastrukturore i shtohet bazës rregullatore të aseteve, mirëpo jo edhe ato të financuara nga grantet.

4.3.7 Baza rregullatore e aseteve bazohet në vlerën fillestare të 2009 (e caktuar sipas çmimeve të mesit të vitit 2008) plus shtesat pa zhvlerësim të indeksuar për normën e inflacionit të mesit të vitit 2008 të bazës rregullatore të asetit, të gjitha të përcaktuara mbi bazën e kontimit të kostos aktuale.

4.3.8 Kthimi në kapital bazohet në një kthim të ‘drejtë’ i cili reflekton koston e kapitalit të ofruesve rajonal të shërbimeve të ujit (përqindja e interesit dhe pritjet e kthimit të ekuitetit).

5. LLOGARITJA E SHITJES

5.1 Logjika

5.1.1 Projektimet e përgjithshme të shitjeve bazohen në planet e biznesit të KRU por i nënshtrohen shqyrtimit të rregullatorit dhe sipas nevojës, bëhen rregullimet për të reflektuar pritjet e ZRRUK për performancën e përmirësuar.

5.1.2 Totali i pritjeve të shitjes vjetore të ujit (m3) përcaktohet në bazë të vlerësimeve më të mira të ofruesve të shërbimeve, të vëllimit të ujit të shitur duke marr parasysh ngritjet e pritura në kapacitetin e prodhimit, prodhimin aktual dhe vlerësimet reale të aktiviteteve të reduktimit të UPF.

5.1.3 Rritja e prodhimit do të reflektojë çdo investim për pritjet në ngritjen e shërbimeve (bilanci i kërkesës dhe furnizimit si dhe niveli i shërbimeve), zgjerimin e dukshëm të shërbimeve. KRU do të duhet të ofrojnë të dhëna mbështetëse sipas nevojës.

5.1.4 Projektimet e shitjes së ujit do të ndahen sipas kategorive të konsumatorëve: kons.shtëpiak dhe jo-shtëpiak. Kompanitë rajonale të ujit do të ofrojnë informacione të mjaftueshme për të vërtetuar vlerësimet e arsyeshme të projektimeve të tilla sipas kategorive.

5.1.5 Numri i projektuar i konsumatorëve (sipas kategorive) për çdo vit kërkohet për të caktuar bazën me anë të së cilës përcaktohen çmimet e kyçjeve dhe komponentët e tarifës fikse dhe të cilat do të hiqen nga kërkesat për të ardhura gjatë përcaktimit të tarifës.

5.1.6 Vëllimi i projektuar i shitjes së ujit i bazuar në vlerësime, për shkak të gabimeve në ujëmatësa apo të ujëmatësve të pa instaluar, sipas kategorive kërkohet me qëllim që të përcaktohet shkalla në të cilën mund të ndikohen të ardhurat nga programi i ujëmatjes dhe se a e tejkalon ndikimi kufirin e caktuar me parë, i cili mund të nxisë një përshtatje të përkohshme.

5.1.7 Projektimet e shitjeve të ujit sipas kategorive do të përshtaten që të reflektojnë borxhet e pakthyeshme (të papaguara). Përshtatja për borxhe të pakthyeshme do t'i nënshtrohet shqyrtimit nga ZRRUK për të caktuar nivelin e duhur të borxheve të rimbursueshme[6].

[6] Udhëzimet rregullatore të kontabilitetit kanë rekomanduar që borxhet e pakthyeshme t'i referohen borxheve të këqija më shumë se 12 muaj të vjetër, të cilat nuk ka gjasa të arkëtohen dhe se zakonisht do të duhej të fshiheshin (ndonëse shlyerja formale e borxheve është ende çështje e cila duhet të rregullohet në mes të KRU dhe administratës tatimore).

6. PASQYRIMI I KËRKESAVE PËR TË ARDHURA

6.1.1 Kërkesat për të ardhura paraqesin të ardhurat e nevojshme nga KRU në mënyrë që të paguajnë koston e udhëheqjes së biznesit të tyre dhe të financojnë investimet e tyre. Llogaritet në baza vjetore në kushte reale sipas çmimeve të vitit bazik (mesi 2014). Komponentët kryesor të kërkesave për të ardhura janë shpenzimet operative, mirëmbajtja e kapitalit dhe kthimi para tatimor në bazën rregullatore të asetit.

6.1.2 Shpenzimet operative përbëhen prej shpenzimeve operative të sistemit të cilat janë në atë vit. Kjo përfshinë shpenzimet operative të shërbimeve bazë dhe neto ndryshimet në shpenzimet operative që vijnë si rezultat i ngritjes së cilësisë, zgjerimit dhe ndryshimeve në nivelin e shërbimeve. Shpenzimet operative duhet, poashtu, të përfshijnë shpërndarjen e shpenzimeve të përbashkëta.

6.1.3 Mirëmbajtja kapitale përbehet prej shpenzimeve afatgjata të mirëmbajtjes së sistemeve të aseteve. Kjo përbën shpenzimet e rritjes infrastrukturore të aseteve nëntokësore (infrastrukturore) dhe zhvlerësimin e kostos aktuale[7] për asetet mbi tokësore (jo-infrastrukturore).

6.1.4 Kthimi në kapital është kthimi në bazën rregullatore të asetit (BRA). BRA përcaktohet nga vlera fillestare (2009 e kapitalizuar me fundvitin 2013), pa zhvlerësim si dhe pa grante dhe kontribute tjera. Norma e kthimit në BRA do të përcaktohet nga ZRRUK. Në rishikimin e mëhershëm tarifor 2012-2014 është vendosur për 5.3% dhe ZRRUK tashmë është në proces të shqyrtimit të kësaj norme për periudhën 2015-2017.

[7] Kontimi i kostos aktuale për qëllime të llogarive të rregullatorit është thjeshtë indeksim i shpenzimeve, vlerës se aseteve dhe provizionimit të amortizimit në pajtim me treguesit e publikuar të inflacionit në Kosovë. Vlerat e ekuivalentit modern të aseteve (EMA) nuk merren parasysh në këtë proces.

7. SHPENZIMET OPERATIVE

7.1 Të përgjithshme

7.1.1 Kjo pjesë paraqet komponentët e ndryshëm të parashikimeve të shpenzimeve operative për periudhën e rishikimit. Shpenzimet operative të përcaktuara do të përfshihen gjatë kërkesës për të ardhura dhe do të përdoren për të përcaktuar të ardhurat e lejuara për çdo vit të periudhës së rishikimit.

7.1.2 Provizionimet në lidhje me planin e biznesit dhe se si përcaktohen parashikimet nuk janë brenda fushëveprimit të këtyre procedurave.

7.1.3 Shpenzimet operative të projektuara ndahen në dy qendra të profitit: furnizimi me ujë dhe shërbimet e ujërave të zeza.

7.1.4 Shërbimet e furnizimit me ujë ndahen në:

1. Shpenzimet e drejtpërdrejta të përbëra prej:
   a. Resurset dhe trajtimit i ujit
   b. Distribuimi i ujit
2. Aktivitetet qëndrore të biznesit (shërbimi me konsumatorë, shpenzimet e përbashkëta, etj.)

7.1.5 Shërbimet e ujërave të zeza janë të nën ndara në:

1. Shpenzimet e drejtpërdrejta të përbëra prej:
   a. Grumbullimit të ujërave të zeza
   b. Trajtimit të ujërave të zeza
   c. Trajtimit dhe derdhjes së llumit
2. Aktivitetet e përbashkëta (qendrore) të biznesit (shërbimi me konsumatorë, shpenzimet e përbashkëta, etj.)

8. ZHVLERËSIMI I KOSTOS AKTUALE

8.1 Të përgjithshme

8.1.1 Asetet fikse të KRU janë të ndara në dy kategori -asete nëntokësore (apo infrastrukturore) dhe asete sipërfaqësore (jo-infrastrukturore). Asetet nëntokësore nuk zhvlerësohen por shpenzimet për të mirëmbajtur shërbimet ndaj konsumatorëve të kyçur në rrjet janë të përfshira në koston e përtritjes infrastrukturore (KPI).

8.1.2 Kërkesat për të ardhura përfshijnë një element për shpenzimet e zëvendësimit të aseteve të zhvlerësueshme të shpërndara përgjatë jetës ekonomike të asetit. Ky është zhvlerësimi i kostos aktuale (ZHKA).

8.2 ZHKA në vlerën fillestare (2009) të bazës rregullatore të asetit

8.2.1 Vlera fillestare e Bazës rregullatore të aseteve ndahet ne mes të aseteve infrastrukturore dhe jo-infrastrukturore. Komponenti i asetit jo-infrastrukturor i vlerës fillestare duhet të zhvlerësohet në bazë lineare gjatë 35 viteve.).

8.3 ZHKA në asetet ekzistuese jo-infrastrukturore

8.3.1 Për asetet e blera/të vëra në funksion pas 1 Janarit 2009 zhvlerësimi i kostos aktuale do të caktohet në pajtim me udhëzimet e kontabilitetit rregullator (pa përfshirë grantet) dhe projektimet bëhen duke u bazuar në çmimet bazike (mesi i vitit 2014). Të gjitha asetet mendohet të jenë blerë /vërë në funksion në pikën e mesit të vitit të blerjes/vënies në punë.

8.4 ZHKA në asetet e reja jo-infrastrukturore

8.4.1 ZHKA në investimet e reja (pa përfshirë grantet) në asetet jo-infrastrukturore në periudhën raportuese duhet të përcaktohet në pajtim me udhëzimet e kontabilitetit rregullator. Të gjitha asetet do të konsiderohen të jenë blerë/vënë në funksion prej mesit të vitit të blerjes/vënies në funksion.

9. PËRTRITJET INFRASTRUKTURORE DHE RRITJET INFRASTRUKTURORE

9.1 Koncepti

9.1.1 Kontimi i përtritjes infrastrukturore përdoret për asetet nëntokësore më shumë se sa për zhvlerësimin konvencional. Kostoja e përtritjes infrastrukturore (KPI) që reflekton shpenzimin aktual për përtritjen infrastrukturore, bëhet çdo vit dhe është përfshirë në kërkesat për të ardhura.

9.1.2 KPI përcaktohet në bazë të shpenzimeve të nevojshme për të mirëmbajtur nivelin bazik të shërbimeve dhe përjashton shpenzimet për rritje infrastrukturore e cila i shtohet bazës rregullatore të asetit. Rritja infrastrukturore përfshinë shpenzimet e bëra për të financuar pagesën e mbetur për përtritjen infrastrukturore, përmirësimin e kualitetit të ujit, nivelet e shërbimeve dhe arritjen e bilancit furnizim/kërkesë (duke përfshirë zgjerimin e shërbimit).

9.1.3 Grantet kapitale dhe kontributet e atribueshme në përtritjen infrastrukturore nuk përfshihen në kërkesat për të ardhura.

9.1.4 Grantet kapitale dhe kontributet e atribueshme në rritjen infrastrukturore nuk i shtohen bazës rregullatore të asetit.

10. KONTRIBUTET KAPITALE

10.1 Kontributet kapitale

10.1.1 Kontributet kapitale paguhen nga kompanitë ndërtuese dhe konsumatorët për zhvillimin e infrastrukturës e cila është specifike për nevojat e kompanive ndërtuese apo konsumatorit, p.sh. linja e re e gypave në një fabrikë dhe mbulimi i shpenzimeve për përmirësimin e rrjetit të distribuimit për të plotësuar kërkesat shtesë.

10.1.2 Kontributet kapitale do të kufizohen në koston e çfarëdo infrastrukture të dedikuar dhe zgjerimit të rrjetit, duke përfshirë stacionet e pompave dhe objektet e deponimit por nuk përfshinë resurset e ujit dhe objektet për trajtimin e ujit.

10.1.3 Rregullimet në bazën rregullatore të asetit do të bëhen duke marr parasysh koston e investimeve, por jo edhe të kontribuesve tjerë.

10.2 Taksa e Kyçjes

10.2.1 Të ardhurat nga pagesat e kyçjeve konsiderohen si kontribut kapital dhe do të zbriten nga kërkesat për të ardhura.

11. BAZA RREGULLATORE E ASETEVE

11.1 Koncepti

11.1.1 Baza rregullatore e aseteve paraqet kapitalin bazë në bazë të cilit KRU kanë të drejtë për kthim. Paraqet një nivel të investimeve të bëra në KRU nga investitorët dhe huadhënësit (ekuiteti dhe borxhi).

11.1.2 Vlera fillestare e bazës rregullatore të asetit në vitin bazik është një input (e dhënë hyrëse) në modelin financiar.

11.1.3 Shpenzimet kapitale për investimet jo-infrastrukturore i shtohen bazës rregullatore të asetit dhe zhvlerësimi i kostos aktuale zbritet nga baza rregullatore e aseteve.

11.1.4 Kostot për përtritjen infrastrukturore nuk i shtohen bazës rregullatore të asetit

11.1.5 Kostot për rritjen infrastrukturore i shtohen bazës rregullatore të asetit.

11.2 Vlera fillestare e aseteve rregullatore

11.2.1 Vlera fillestare e asetit përcaktohet nga vlera fillestare (2009) dhe shpenzimet kapitale në vijim, pa zhvlerësim dhe pa grante apo kontribute tjera, të indeksuara sipas çmimeve të fund vitit 2014.

11.3 Kapitali punues i përfshirë në bazën rregullatore të aseteve

11.3.1 Kapitali punues duhet të përfshihet në bazën rregullatore të asetit dhe nuk do të bëhen përshtatje për ndryshime në kapitalin punues.

12. KTHIMI NË KAPITAL

12.1 Niveli

12.1.1 Kthimi në bazën rregullatore të aseteve është kthim real, d.m.th. i përshtatur për inflacion dhe duhet të përcaktohet nga ZRRUK duke marrë parasysh kushtet financiare të tregut në Kosovë dhe më gjerë.

12.2 Përfshirja në kërkesën për të ardhura

12.2.1 Kërkesa për të ardhura do të përfshijë provizionimin e kthimit në kapital, të llogaritur sipas normës të paraqitur nga ZRRUK të shumëzuar për vlerën mesatare të bazës rregullatore të aseteve gjatë periudhës së raportimit.

13. LLOGARITJA E TARIFAVE

13.1 Koncepti

13.1.1 Tarifat për m3 përcaktohen në bazë të shumës së shpenzimeve operative apo të shpenzimeve të mirëmbajtjes dhe kthimit në bazën rregullatore të aseteve e pjesëtuar me nivelin e pritur të shitjes së ujit dhe pagesës për të.

13.2 Zbutja

13.2.1 Tarifat mund të caktohen ose në bazë të tarifave të zbutura apo të pa zbutura.

13.2.2 Për opcionin e pa zbutur tarifat e rezultuara janë përcaktuar në baza 'prej viti në vit' i shprehur në terma reale. Kjo do të rezultojë me ngritje apo zvogëlim vjetor të tarifave në terma reale (faktorët K). Rezultimi i tarifave të pa zbutura do të rregullohet për normën e inflacionit siç është përcaktuar me indeksin e çmimit me pakicë (IÇP) plus faktori K.

13.2.3 Për tarifat e zbutura, vlera uniforme e konstantës K përcaktohet ashtu që e siguron të njëjtën VTN sikurse tarifat e pa zbutura. Zbutja i ka tri variante:

1. Cakton tarifën mesatare të vitit 1 (të parë) dhe pastaj përcakton një përqindje mesatare vjetore të ngritur për vit që siguron të njëjtën VTN sikurse tarifat e pa zbutura;
2. Cakton tarifën mesatare për kons. shtepiak të vitit 1 (të parë) dhe pastaj përcakton një përqindje mesatare vjetore të ngritur për vit që siguron të njëjtën VTN sikurse tarifat e pa zbutura;
3. Tarifat uniforme gjatë periudhës tre vjeçare të cilat sigurojnë të njëjtën VTN sikurse tarifat e pa zbutura.

Opcioni i pa zbutur dhe tri opsionet e zbutjes tarifore përcaktohen në modelin e tarifave dhe përzgjedhja e opcionit duhet të bëhet përmes Fletës kontrolluese në modelin e biznes planit rregullator.

14. INDEKSIMI

14.1 Koncepti

14.1.1 Të gjitha shpenzimet e përcaktuara me këto procedura janë të përllogaritura sipas çmimeve të mesit të vitit që i paraprinë fillimit të periudhës së rishikimit tarifor, d.m.th. mesi i vitit 2014.

14.1.2 Vlera fillestare e tarifave të vitit 2015 duhet të përcaktohet bazuar në çmimet e mesit të vitit 2014 të shumëzuar me indeksin e inflacionit për periudhën Dhjetor 2013- Nëntor 2014[8].

14.1.3 Tarifat në vijim do të përshtaten për shifrat e inflacionit të vitit që paraprinë, d.m.th. tarifat e vitit 2016 duhet të përshtaten për inflacion gjatë periudhës Dhjetor 2014- Nëntor 2015.

14.1.4 Tarifat e vitit 2017 përshtatet për shifrat e inflacionit të vitit që paraprinë, d.m.th. tarifat e 2017 duhet të përshtaten për inflacion e periudhës Dhjetor 2015- Nëntor 2016.

14.1.5 Tarifat do të lejojnë përshtatjen ndaj ndikimeve të inflacionit duke u bazuar në indeksin e çmimit të konsumimit të përgjithshem (IÇK).

14.2 Metoda

14.2.1 Për vitin e parë (2015) tarifa e përcaktuar fillestare me çmimet e mesit të vitit 2014 shumëzohet me shkallën e inflacionit në mes të Dhjetorit 2013- Nëntor 2014 për të arritë te çmimi bazë i vitit 2015.

14.2.2 Më pas tarifa do të caktohet sipas tarifës së vitit 1 dhe do të përshtatet në baza vjetore si:

$$\text{Tarifa e përshtatur}_{2016} = \text{tarifa model}_{2016} \times (1 + \text{IÇK}_{\text{dhjetor 2014 –nëntor 2015}}), \text{ dhe}$$

$$\text{Tarifa e përshtatur}_{2017} = \text{tarifa model}_{2017} \times (1 + \text{IÇK}_{\text{dhjetor 2015 –nëntor 2016}})$$

[8] Treguesit e inflacionit për 12 muajt e kaluar të çdo viti përkatës (Dhjetor- Nëntor) përdoren në bazë të dhënave të publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës.